




Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina”
Zyra e Teknologjisë së Informacionit, Administrata Qendrore - Rektorat

NJOFTIM

Të dashur studentë,

Në kuadër të masave mbrojtëse ndaj koronavirusit (COVID-19), Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina” ka krijuar e-mail të personalizuar në Google “G Suit for Education” për secilin nga ju, në mënyrë që ju të mund të vazhdoni mësimin online pa pengesë gjatë kohës së evitimit të kontaktit fizik.

E-maili juaj:

1. E-mailat janë krijuar në formatin **emri.mbiemri@student.uni-pr.edu**, ndërsa fjalëkalimi juaj do të jetë **numri personal i letërnjoftimit** tuaj.
2. Për të parë se cili është e-maili juaj, ju mund gjithashtu të kyçeni në SEMS përmes linkut: notimi.uni-pr.edu -> klikoni në logon e Profilit të Shfrytëzuesit () -> Profili Përdoruesit, pastaj do të ju shfaqen të dhënat e profilit ku ndër të tjera është edhe e-maili juaj zyrtar i universitetit.

Mësimi Online:

I gjithë stafi akademik dhe studentët e Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina” janë të pajisur me e-mail zyrtar në Google, prandaj mund të bashkëveprojnë duke shfrytëzuar platformat në vazhdim:

Produkti/Shërbimi	Linku	Përshkrimi
Google Meet Qasja përmes e-mailit zyrtar të Universitetit: @uni-pr.edu (për stafin) ose @student.uni-pr.edu (për studentët)	https://meet.google.com VIDEO rreth produktit: https://www.youtube.com/watch?v=2jhTTzFMZKY	Video konferencë, e cila mund të shfrytëzohet për krijimin e sesioneve dhe shpërndarjes së kodit të sesionit, i cili ua mundëson studentëve të inkuadrohen në ligjëratën që po ligjërohet drejtpërdrejtë nga profesori.

<p>Google Classroom</p> <p>Qasja përmes e-mailit zyrtar të Universitetit: @uni-pr.edu (për stafin) ose @student.uni-pr.edu (për studentët)</p>	<p>https://classroom.google.com</p> <p>VIDEO rreth produktit: https://www.youtube.com/watch?v=lw0T0uotAE8&list=PLP7Bvyb3ap44G3Gt_mTxOHoCclYTBlixg</p>	<p>Krijimi i klasave në të cilat mund të regjistrohen studentët, të shpërndahen detyrat e shtëpisë, materialet mësimore, vlerësohen punimet. Është një platformë shumë funksionale e ndërveprimit profesor-studentë.</p>
<p>Google Drive</p> <p>Qasja përmes e-mailit zyrtar të Universitetit: @uni-pr.edu (për stafin) ose @student.uni-pr.edu (për studentët)</p>	<p>https://drive.google.com/</p> <p>Video: https://www.youtube.com/watch?v=pgdwQJqybQc</p>	<p>Shpërndarja e materialeve për studentë. Pasi të vendosen materialet, ato mund të shpërndahen përmes linkut, pastaj nëpërmjet e-mailit, rrjeteve sociale, apo metodave të tjera të komunikimit.</p>
<p>Microsoft Teams</p> <p>Qasja përmes e-mailit zyrtar të office 365: @office.uni-pr.edu</p>	<p>https://teams.microsoft.com</p> <p>Video: https://www.youtube.com/watch?v=jugBQqE_2sM</p>	<p>Përmes kësaj platforme mund të krijohen grupe nga profesorët, në të cilat mund të mbahen ligjërata/konferenca, diskutime, shpërndarje e materialeve, ndahen detyra dhe studentët e profesorët të bashkëpunojnë.</p>

Zyra e Teknologjisë së Informacionit rekomandon:

- Google Meet – për mbajtjen e ligjëratave,
- Google Classroom - për shpërndarjen e detyrave dhe materialeve

Në mënyrë që të përfitoni nga këto shërbime ju duhet gjithmonë ta shfrytëzoni e-mailin zyrtar të ofruar nga Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina”.

Gjatë kësaj periudhe ju lusim, që në rast të nevojës veproni si më poshtë:

- Në rast të problemeve me hapjen e e-mail-it zyrtar shkruani në: support@student.uni-pr.edu.
- Në rast se keni probleme me SEMS shkruani në apliko@uni-pr.edu

Zyra e Teknologjisë së Informacionit është e gatshme të ofrojë mbështetje gjatë gjithë kohës për të evituar çfarëdo problemi që mund të ju shfaqet gjatë shfrytëzimit të shërbimeve elektronike.

Me respekt,

Zyra e Teknologjisë së Informacionit,
Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina”